



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 28, datë 28.04.2022

PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË RINDËRTIMIT TË PËRFITUAR NË
ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 167, DATË 18.03.2022
“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË,
KAMZË DHE RROGOZHINË”

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 18.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit, në masën 462 554 300 (katërqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte, që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara në bashkinë Durrës.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkia Durrës, në masën 277 532 580 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte, që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas tabelës së mëposhtëme:

VKM që ka miratuar fondin	Gr	Kap	Prog-ami	Llog-ekon	Kodi i produktit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë në lekë	Financimi për 2022 në lekë
NR.167, DT.18.03.2022	00	1	04960	606	94902AC	Financimi i rindërtimit të banesave individuale për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para	462 554 300	277 532 580
						TOTALI	462 554 300	277 532 580

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.04.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 395 / prot.
3

Durrës, më 06.05 .2022



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit:

KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.28 datë 28.04.2022 “Për miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit të përfituar në zbatim të VKM Nr 167 dt 18.03.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në Bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

